



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 117/1 Prot

Tiranë, më 09.05.2022

V E N D I M

Nr. 62, datë 09.05.2022

Mbi përfundimin e procedimit administrativ për vlerësimin e ligjshmërisë së aktit nr. 1126, datë 03.11.2021, të Kryetarit të Bashkisë Elbasan, për lirimin nga shërbimi civil të nëpunësit civil *** , për shkak të ristrukturimit të institucionit.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 95, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur dhe propozimit të paraqitur prej Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me pretendimin për lirimin nga shërbimi civil dhe ndërprerje të marrëdhënieve financiare, për shkak ristrukturimi.

VËREJ SE:

Pas shqyrtimit të përmbajtjes së një kërkesë, të regjistruar me nr. 1055 prot, datë 02.12.2021, paraqitur nga nëpunësi ***** , konstatohet se ky nëpunës, me detyrë “Specialist në Sektorin e Vlerësimit dhe Përballimit në Drejtorinë e Emergjencave”, në Bashkinë Elbasan, pretendon për shkelje të legjislacionit të shërbimit civil dhe moszbatim të kërkesave të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, gjatë kryerjes së veprimit administrativ të lirimit nga shërbimit civil dhe ndërprerjes së marrëdhënies financiare, për shkak të ristrukturimit dhe riorganizimit të institucionit.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të mbledhur gjatë hetimit administrativ të çështjes, ka rezultuar e vërtetuar se nëpunësi *****, është emëruar rregullisht, pas kryerjes së procedurës së konkurrimit, në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Vlerësimit dhe Përballimit*” në Drejtorinë e Emergjencave, në Bashkinë Elbasan, me aktin nr. 692, datë 03.11.2017, të njësisë përgjegjëse.

Ai, ka vazhduar të punojë në këtë pozicion pune deri në momentin kur, pas miratimit të strukturës së re, Sekretari i Përgjithshëm i Bashkisë Elbasan, me shkresën e tij nr. 5245 dt. 26.10.2021, e ka vënë në dijeni për vendimin e njësisë përgjegjëse, për lirimin nga detyra për shkak të ristrukturimit të institucionit, pas propozimit të Komisionit të Ristrukturimit.

Nga dokumentacioni i administruar rezulton se procesi i ristrukturimit të institucionit të Bashkisë Elbasan, ka filluar me urdhrin nr. 866, datë 04.10.2021, të Kryetarit të Bashkisë Elbasan, “*Për miratimin e strukturës të Bashkisë Elbasan*”, pasi është përcaktuar numri i përgjithshëm i punonjësve nga Këshilli Bashkiak Elbasan.

Nga analiza dhe krahasimi i strukturës së mëparshme, dhe strukturës aktuale, vërehet se jemi para një rasti të shkurtimit të dukshëm të vendeve të punës, sidomos në Drejtorinë e Emergjencave Civile, në përbërje të së cilës ishte punësuar nëpunësi *****.

Konkretisht, ndërsa më parë Bashkia Elbasan kishte 414 pozicione pune, në strukturën e re ka 391 pozicione, pra 23 pozicione pune, më pak.

Sipas strukturës në fuqi, Drejtoria e Emergjencave është njësi e rikonceptuar, e cila është rrjedhojë e bashkimit të “*Sektorit të Vlerësimit dhe Përballimit të Emergjencave*”, me “*Sektorin e Kryerjes së Procedurave dhe Parandalimit në Sektorin e Parandalimit dhe Mbulimit në Terren të Emergjencave Civile*”, e mbi këtë bazë krijimit të një sektori të ri, të emërtuar “*Spektori i Politikave të Kompensimit për Fatkeqësitë Natyrore dhe Koordinimit të Strukturave Vullnetare*”.

Në këtë mënyrë është përmirësuar ndarja e funksioneve dhe është zgjeruar mbulimi i problematikave të qytetarëve të prekur nga fatkeqësitë e natyrës. Bashkimi dhe rikonceptimi i këtyre dy sektorëve, është shoqëruar me uljen e numrit të punonjësve në këtë drejtori, nga 13, në 8 punonjës, duke surprimuar në këtë mënyrë, 5 pozicione pune.

Pasi ka konstatuar sa më sipër, Komisioni i Ristrukturimit, mbështetur në nenin 50, të ligjit nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar, ka vlerësuar që nëpunësi *****, është njëri prej nëpunësve që u shkurtohet vendi i punës, duke vijuar më tej me shqyrtimin e mundësisë për sistemimin e tij, në ndonjë nga pozicionet e mbetura apo krijuara pas ristrukturimit në Bashkinë Elbasan, duke vlerësuar të dhënat e dosjes së personelit, përvojën në punë, llojin dhe nivelin arsimor, kualifikimet e kryera, etj.

Duke marrë parasysh faktin se nëpunësi në fjalë, zotëron diplomë “*Inxhinieri Ndërtimi*”, Dega Gjeodezi, lëshuar nga Univeristeti Politeknik i Tiranës, Komisioni i Ristrukturimit i Bashkisë Elbasan, ka arritur në përfundimin se kualifikimi i tij është specifik dhe nuk përputhet me objektivat dhe kërkesat e veçanta të ndonjë prej pozicioneve të mbetura apo riorganizuara pas ristrukturimit, prandaj duke e vlerësuar të pamundur sistemimin e tij, Komisioni i Ristrukturimit, ka propozuar përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për këtë nëpunës. Vendimi përfundimtar është marrë nga njësia e burimeve njerëzore e cila, me aktin nr. 1126, datë 03.11.2021 “*Për përfundimin e Marrëdhënies në Shërbimin Civil*”, ka liruar nëpunësin ***** nga detyra, për shkak të ristrukturimit të institucionit.

Në përfundim, nga analiza në tërësi e dokumentacionit të administruar konstatohet që, veprimet e njësisë përgjegjëse dhe aktorëve të tjerë në këtë proces, janë kryer në përputhje me kërkesat e nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave “*Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë*”, duke përcaktuar si shpërblimin në bazë të vjetërsisë, ashtu dhe deklarin e mundësisë së konkurrimit, brenda një afati dy vjeçar nga dita e ndërprerjes së marrëdhënies në shërbimin civil, parashikuar nga pikat 7 dhe 8 të nenit 50, të ligjit të sipërpërmendur.

Nga sa është parashtruar më sipër, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, arrin në përfundimin se menaxhimi i rastit të nëpunësit ***** , nga njësia e burimeve njerëzore të Bashkisë Elbasan, është kryer në përputhje me kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil, prandaj është me vend të vendoset përfundimi i hetimit administrativ të nisur mbi bazën e kërkesës së regjistruar me nr. 1055 prot, datë 02.12.2021, dhe çështja të arkivohet.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, në nenin 90/2, të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”, i cili parashikon, përfundimin e procedurës administrative, kur objekti për të cilin ka nisur procedura është realizuar, si dhe në mbështetje të nenit 16, pika 6, të Rregullores, “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

- 1- Përfundimin e hetimit administrativ, filluar në bazë të kërkesës nr. 1055 prot, datë 02.12.2021, të nëpunësit ***** , në lidhje me verifikimin e disa pretendimeve të paraqitura, për parregullsi të kryera apo lejuara në zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil, gjatë procesit administrativ të lirimit të tij nga detyra në pozicionin “*Specialist*”

në Sektorin e Vlerësimit dhe Përballimit në Drejtorinë e Emergjencave”, për shkak të ristrukturimit të institucionit, Bashkia Elbasan dhe arkivimin e çështjes, pasi nuk u konstatuan parregullsi në administrimin e shërbimit.

- 2- Të njoftohet për këtë vendim Sekretari i Përgjithshëm i Bashkisë Elbasan, Drejtorja e Burimeve Njerëzore i këtij institucioni, dhe nëpunësit *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha